

V E N D I M
Nr.307, datë 30.4.1997

**PËR NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN E KUVENDIT POPULLOR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 18 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese"

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

1. Në pjesën e Rregullores "Për Kryesinë, komisionet e përhershme e të përkohshme dhe Byronë e Grupit Ndërparlamentar", në nenin 8, komisioni për arsimin, shkencën e sportet, bashkohet me komisionin e kulturës, rinisë e gruas, duke formuar një komision të vetëm me 14 anëtarë
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.